

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 452 Prot.

Tiranë, më 25.04 2016

VENDIM Nr. 27, datë 13.04.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4 të datës 13.04.2016, pasi shqyrtoi Raportin e vrojtimit sipërfaqësor për Sheshin e grumbullimit të tubave nr. 2 dhe Kampin e punës nr. 2 në Fllaq, Korçë; Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike në Sheshin e grumbullimit të tubave nr. 2 dhe Kampin e punës nr. 2 në Fllaq, Korçë, ***në kuadër të projektit TAP***, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" SH.P.K.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e vrojtimit sipërfaqësor për Sheshin e grumbullimit të tubave nr. 2 dhe Kampin e punës nr. 2 në Fllaq, Korçë; Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike në Sheshin e grumbullimit të tubave nr. 2 dhe Kampin e punës nr. 2 në Fllaq, Korçë, ***në kuadër të projektit TAP***, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" SH.P.K.
2. Shoqëria "TAP-AG" për kryerjen e sondazheve arkeologjike në Sheshin e grumbullimit të tubave nr. 2 dhe Kampin e punës nr. 2 në Fllaq, Korçë, ***në kuadër të projektit TAP***, sipas konceptit dhe metodologjisë të paraqitur nga shoqëria e licencuar në arkeologji "ABKONS" Sh.P.K., duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me shoqërinë e licencuar në arkeologji dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

